

35/2
15.5.2015

(19) t

ALBKROM SH.A.
(SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER)

PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Me raportin e audituesve të pavarur bashkëlidhur)

PERMBAJTJA

Permbajtja.....	2
Raporti i audituesve te pavarur.....	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	5
Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	6
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital.....	7
Pasqyra e Flukseve te Parase.....	8
Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare	9
Të përgjithshme.....	9
Bazat e përgatitjes.....	9
Politikat kontabël të rendësishme	9
Shpjegime për zërat kryesorë të pasqyrave financiare.....	13-19

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Drejtuar :

Aksionerit të Vetëm të shoqërisë "ALBKROM" sh.a. Tiranë, Shoqëri në Likuidim e Sipër.
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Këshillit Mbikqyrës dhe Likuidatorit të shoqërisë "ALBKROM" sh.a. Tiranë, Shoqëri në Likuidim e Sipër.

Raporti mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të Shoqërisë "ALBKROM" sh.a. Tiranë, Shoqëri në Likuidim e Sipër, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 Dhjetor 2014 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e përfunduar në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin, gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Baza për opinionin me rezervë

Shoqëria nuk ka vlerësim të plotë me vlerë tregu të inventarit të Aktiveve Afatgjata Materiale. Shoqëria nuk ka përfundur regjistrimin e objekteve në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Të drejtat dhe detyrimet e mbartura nga bashkimi i njësisve nuk janë tërësisht të mbështetura me dokumentacion justifikues.

Ne nuk marrëm pjesë në procesin e inventarizimit të aktiveve afatgjata dhe të stokut më datën 31 dhjetor 2014, pasi ne jemi emëruar në një datë të mëvonëshme dhe për shkak të natyrës të gjendjes së stokut në galeri dhe miniera dhe natyrës së regjistrave të shoqërisë, ne nuk ishim në gjendje të formonim bindjen mbi sasinë dhe vlerësimin e inventarëve të regjistruar më 31 dhjetor 2014.

Opinion

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshme të çështjeve të përmendura në paragrafin e bazës së opinionit me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të shoqërisë "ALBKROM" sh.a. Tiranë, Shoqëri në Likuidim e Sipër, më datën 31 Dhjetor 2014, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

Ekspertë Kontabël të Regjistruar

Arjeta ÇUMANI



Eldar KAZO



Tiranë, më 15 Maj 2015

ALBKROM SH.A. SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
AKTIVET			
Aktive afat-shkurtra			
Aktive monetare	4	1,065,349	225,124
Llogari te arketueshme	5	51,173,676	12,407,940
Llogari te tjera te arketueshme	6	98,062,778	138,529,099
Inventari	7	7,049,065	17,360,264
		157,350,868	168,522,427
Aktive afatgjata			
Investime financiare afatgjata	8	1,400,101	1,629,137
Aktive afatgjata materiale	9	174,709,248	181,387,626
Aktive afatgjata jomateriale	10	3,984,058,464	3,984,058,464
		4,160,167,813	4,167,075,227
Totali i aktiveve		4,317,518,681	4,335,597,654
DETYRIMET			
Detyrime afat-shkurtra			
Huatë dhe parapagimet	11	6,637,486	664,650
		6,637,486	664,650
Detyrime afat-gjata			
Huatë afatgjata	12	63,144,352	63,144,352
Huamarrje të tjera afatgjata	13	383,149,817	296,501,696
Grantet dhe të ardhurat e shtyra	14	106,201,290	106,201,290
Te drejta e detyrime te Konçensionarit	15	2,342,415,718	2,342,415,718
		2,894,911,177	2,808,263,056
Totali i detyrimeve		2,901,548,663	2,808,927,706
KAPITALI			
Kapitali aksionar dhe rezervat			
Kapitali aksionar	16	3,405,413,240	3,405,413,240
Rezerva rivleresimi		1,547,029,358	1,547,029,358
Rezerva ligjore		39,410,111	39,410,111
Rezerva të tjera		25,074,303	25,074,303
Humbje të mbartura		(3,598,514,639)	(3,461,739,282)
Humbje e vitit financiar		(2,442,354)	(28,517,782)
Totali i kapitalit		1,415,970,019	1,526,669,948
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		4,317,518,681	4,335,597,654

Likujdatori

Z. Mentor Spahiu

Kryetari Deges se Finances

Zj. Esma Selmani

ALBKROM SH.A. SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shitjet neto	17	18,478,691	4,908,240
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	18	12,260,870	27,430,677
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme	19	(11,947,007)	(3,700,000)
Materiale te shitura	20	(1,286,238)	-
Kosto e punës	21		
Pagat e personelit		(12,697,326)	(13,708,085)
Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(2,106,425)	(2,236,492)
Amortizimet dhe zhvlerësimet	22	-	(7,295,040)
Shpenzime të tjera	23	(5,170,120)	(34,290,718)
Humbja nga veprimtaria kryesore		(2,467,556)	(28,891,418)
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare			
Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	24	(5,955)	373,636
Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimi	25	31,156	-
Humbja para tatimit		(2,442,354)	(28,517,782)
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	26	-	-
Humbja neto e vitit financiar		(2,442,354)	(28,517,782)

Likujdatori

Z. Mentor Spahiu



Kryetari Deges se Finances

Zj. Esma Selmani

ALBKROM SH.A. SHOQËRI NE LIKUJDIM E SIPER

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

	Kapitali aksioner		Rezerva ligjore, statusore, etj.		Fitimi i pashperndare		Totali
Pozicioni me 31 Dhjetor 2012	3,405,413,240		1,609,546,772		(3,336,278,832)		1,678,681,180
Efekt i ndryshimit ne politikat kontabel							-
Pozicioni i rregulluar	3,405,413,240		1,609,546,772		(3,336,278,832)		1,678,681,180
Fitimi/Humbje neto per periudhen kontabel					(28,517,782)		(28,517,782)
Rritje e rezervave te tjera			1,967,000				1,967,000
Sistemim veprime kreditore nga vite te kaluara					(125,460,450)		(125,460,450)
Pozicioni me 31 Dhjetor 2013	3,405,413,240		1,611,513,772		(3,490,257,064)		1,526,669,948
Fitimi/Humbje neto per periudhen kontabel					(2,442,354)		(2,442,354)
Rritje e rezervave te tjera							-
Sistemim veprime kreditore/debitore nga vite te kaluara					(108,257,575)		(108,257,575)
Pozicioni me 31 Dhjetor 2014	3,405,413,240		1,611,513,772		(3,600,956,993)		1,415,970,019

Likuidatori

Z. Mentor Spahiu

Kryetari Deges se Finances

Zj. Esma Selmani



(Handwritten signature)

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Pasqyra e Fluksit te Parase	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi para tatimit	(2,442,354)	(28,517,782)
Rregullime për:		
Amortizimin	-	7,295,040
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arkëtueshme të tjera	1,700,585	6,226,428
Rritje/rënie në tepricën inventarit	10,311,199	(1,028,369)
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti	92,620,957	126,603,081
Rritje/rënie llogari tjera A/P	(101,314,082)	(124,057,900)
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet	876,304	(13,479,502)
Aktivitetet investuese		
Blerje te aktiveve afatgjata materiale	(36,080)	-
	(36,080)	-
Aktivitetet financuese		
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare	840,224	(13,479,501)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	225,125	13,704,626
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	1,065,349	225,125

Likujdatori

Z. Mentor Spahiu



Kryetari Deges se Finances

Zj. Esmat Selmani

SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE

1. Të përgjithshme

Shoqëria "ALBKROMI SH.A." me status, Shoqëri në Likujdim e Sipër, është krijuar si shoqëri anonime me kapital tërësisht shtetëror me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, nr. 14014 datë 29.02.1996 me NUIS (NIPT) J61827513H.

Me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane, nr. 14014/5 datë 26.03.2004, është vendosur prishja e shoqërisë dhe kalimi i saj në likujdim sipas Urdhërit nr. 38 datë 01.03.2004, të Ministrit të Ekonomisë, me cilesinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë.

Shoqëria "ALBKROMI SH.A." është shoqëri me një aksioner të vetëm, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, e cila zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 3.405.413.240 leke, i përbërë nga 3.405.413 aksione, me vlerë nominale 1.000 lekë/aksioni.

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë likujdimin e shoqërisë "ALBKROMI" SH.A. Likujdatori aktual i shoqërisë është zoti Mentor Spahiu.

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2014 ka qenë 24 (njëzetë e katër).

Selia e shoqërisë: është në adresën Blloku "Vasil Shanto" Tiranë.
Adresë tjetër e shoqërisë është lagja "Skëndërbej", Durrës.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata për pajtueshmëri

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike dhe vlerën e drejte.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në LEK e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

(d) Përdorimi i gjykimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, kërkon që manaxhimi të bëjë vlerësime dhe gjykime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi dhe në cdo periudhë të ardhme që preket.

3. Politikat kontabël të rëndësishme

(a) Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhat e huaja janë përkthyer me kursin e kembimit të datës së transaksionit. Aktivet monetare në monedha të huaja janë përkthyer në LEK me kursin në ditën e mbylljes së bilancit. Diferencat e konvertimit si pasojë e përkthimit të monedhave të huaja në Leke janë përfshirë në fitim humbje. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj janë raportuar me kursin historik të monedhës së huaj në datën e transaksionit. Aktivet dhe

detyrimet jo-monetare në monedhe të huaj të vlerësuara me vlerën e drejtë janë përkthyer në LEK me kursin e monedhës së huaj në datën e bilancit.

Kurset e kembimit janë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
1 EUR	140.14	140.20
1 USD	115.23	101.86

(b) Instrumentat financiarë

Shoqeria zotëron vetëm instrumenta financiare jo-derivative që përfshijnë llogari klientesh, mjete monetare, dhe llogari të tjera për tu paguar apo për tu arkëtuar me karakter tregetar. Llogarite e arketueshme dhe depozitat, njihen fillimisht në datën e krijimit të tyre. Te gjithë instrumentet e tjera financiare (përfshi dhe ata me vlerë të drejte nepermjet të ardhurave dhe shpenzimeve), njihen fillimisht në datën kur shoqeria behet pale kontraktuale e nje instrumenti.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në banka, investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi me pak se tre muaj të cilat nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqeria në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Llogaritë e klientëve dhe llogari të tjera të arketueshme

Llogaritë e klientëve dhe llogari të tjera të arketueshme janë vlerësuar me vlerën e drejte.

Llogarite e furnitoreve dhe të tjera llogari të pagueshme

Llogaritë e furnitoreve dhe të tjera llogari të pagueshme janë vlerësuar me vlerën e drejte.

Të tjera

Instrumenta të tjere financiare jo-derivative janë vlerësuar me vlerën e drejte.

(c) Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre Shoqeria vlerëson inventarin me vlerën me të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit.

Inventaret i nënshtrohen testit të zhvleresimit në datën e mbylljes së bilancit. Shuma e zhvleresimit njihet në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ka faktore të objektive që tregojnë që inventaret janë zhvlerësuar.

Metoda e vleresimit është kosto mesatare.

(d) Aktivët Afatgjata Materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivët Afatgjata Materiale janë vlerësuar me kosto minus amortizimin e akumuluar sipas SKK 5 "Aktivët AA Materiale dhe AA Jomateriale".

(ii) *Kostot vijuese*

Kosto e zëvendësimit të një pjese përbërëse të një prej aktiveve materiale afatgjata, njihet në vlerën e mbartur të aktivitetit, nëse është e mundur që Shoqëria do të ketë përfitime ekonomike të ardhshme nga ky veprim dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera e mbartur e pjesës së zëvendësuar çrregjistrohet. Kostot e shërbimeve të përditëshme të aktiveve material afatgjata njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.

(iii) *Amortizimi*

Amortizimi për vitin 2014 nuk është llogaritur, pasi Shoqëria "ALBKROMI SH.A." është Shoqëri në Likuidim e Sipër, referuar Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jomateriale".

Amortizimi për vitin 2013 është llogaritur sipas metodës zbritëse (fiskale) duke përdorur normat e amortizimit sipas tabelës së mëposhtme dhe vlerat kontabël neto të AAM.

Kategoria e AAM	Norma e amortizimit në %	
	2014	2013
Toka	-	0%
Ndertesa	-	5%
Galeri	-	5%
Makineri e paisje	-	20%
Mjete Transporti	-	20%
Paisje zyre	-	20%
Paisje informatike	-	25%

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga demtimi ose dalja jashtë përdorimit të një aset, përcaktohen nga diferenca ndërmjet vlerës së përfituar të realizuar dhe vlerës së mbetur kontabël të asetit dhe kjo vlerë njihet si e ardhur apo shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(e) *Çvlerësimi i aktiveve*

(i) *Aktivet financiare*

Aktivet financiare vlerësohen në çdo datë të raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për çvlerësim. Një aktiv financiar çvlerësohet nëse ka evidencë objektive që tregon se ka ndodhur një ngjarje humbjeje pas njohjes fillestare të aktivitetit që ndikon negativisht flukset e ardhshme monetare të vlerësuara për këtë aktivitet dhe nëse këto flukse mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga çvlerësimi i një aktivi financiar të matur me kosto të amortizuara llogaritet si diferenca mes vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të skontuara me interesin efektiv. Humbjet njihen si në llogaritë e fitim/humbjeve ashtu dhe në llogaritë e zbritjeve të arkëtueshmeve.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen individualisht për çvlerësim. Pjesa tjetër e aktiveve grupohen sipas karakteristikave të riskut të kredisë dhe vlerësohen në grup. Të gjitha humbjet nga çvlerësimi njihen në llogaritë e fitim/humbjes.

Kur një ngjarje e mëpasshme ul shumë e njohur të humbjes nga çvlerësimi, ulja e humbjes nga çvlerësimi rimerret në llogaritë e fitim/humbjes.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare me perjashtim te taksave te shtyra, rishikohet ne çdo periudhe raportuese per te percaktuar nese ka ndonje indikator per zhvleresim. Nese ekziston ndonje indikacion i tille, atehere behet vleresimi i shumes se rikuperueshme te aktivitet. Ne kete menyre nje humbje nga zhvleresimi regjistrohet nese vlera e mbartur ne kontabilitet e ketij asetit e tejkalon vleren e rikuperueshme. Keto humbje nga zhvleresimi pasqyrohen ne pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e nje aktivi percaktohet si me e madhja midis vleres se tij te perdorimit dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Ne percaktimin e vleres se perdorimit, parashikimi i flukseve monetare skontohe per te aritur tek vlera aktuale duke perdorur normat e skontimit perpara taksave qe reflekton vleresimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe te rreziqeve specifike te ketij aktivi.

Humbjet nga çvleresimi të regjistruara në periudhat e meparshme rivleresohen ne çdo periudhe raportuese per te pare ndonje indikator nese keto humbje jane zvogeluar ose nuk ekzistojne më. Nje humbje nga çvleresimi rishikohet ne se ka ndonje ndryshim te parashikimeve te bera ne percaktimin e vleres se rikuperueshme. Nje humbje nga rivleresimi rishikohet deri ne ate mase sa vlera e mbartur e aktivitet nuk tejkalon vleren e mbartur neto nga amortizimi, nese kjo humbje nuk do te ishte regjistruar fare.

(f) Përfitimet e punonjësve

Shoqeria, gjate aktivitetit të saj, kryen pagesa ne emer te saj dhe te punonjesve te saj, per te kontribuar ne skemat e pensionit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Kostojta e perballuar ne emer te Shoqerise regjistrohet ne pasqyren e ta ardhurave dhe shpenzimeve ashtu siç ndodhin.

(g) Provizionet për rreziqe

Provizionet pranohen kur Shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor apo të pranuar tërthorazi), si rezultat i ndodhive në të kaluaren dhe ka gjasa qe permbushja e ketyre detyrimeve kerkon sakrifikimin e burimeve ne pronesi te Shoqerise te cilat do te sillnin perfitime ekonomike ne te ardhmen, dhe Shoqeria ka mundesi të percaktoje besueshem vleren e ketyre rreziqeve. Provizionet percaktohen duke bere skontimin e shumave te parashikuara per tu paguar ne te ardhmen me normat e skontimit para tatimit qe reflektojne vleresimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe te rreziqeve specifike te ketij detyrimi.

(h) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e aktiveve të kompanise, të ardhurat nga grandet, qiratë, etj. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet.

(i) Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Te ardhurat dhe shpenzimet jane njohur sipas metodes se konstatimit te te drejtave dhe detyrimeve. Shpenzimet jane njohur ne vitin ushtrimor si dhe te ardhurat qe lidhen me to (procesi i perputhjes se te ardhurave me shpenzimet).

(j) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat nga interesat për llogarite bankare, dhe përfitimet nga diferencat e kembimit. Interesat njihen ashtu siç përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga diferencat e kembimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.

(k) Kostot e huamarrjes

Shoqëria kapitalizon kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar si pjesë e kostos së atij aktivi.

(l) Subvencionet

Subvencionet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se ato do të merren dhe që Shoqëria do të jetë në përputhje me kushtet që i janë bashkëngjitur subvencionit. Subvencionet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë në të cilën ndodhin shpenzimet. Subvencionet që kompensojnë koston e aktiveve të Shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

(m) Operacionet jo të vijueshme

Një operacion jo i vijueshëm është një përbërës i biznesit të Shoqërisë që paraqet një linjë biznesi të ndarë dhe të rëndësishme ose një zonë gjeografike të veprimit që është nxjerrë jashtë përdorimi ose mbahet për tu shitur, ose një filial i blerë ekskluzivisht me qëllimin për tu rishitur. Klasifikimi si operacione jo të vijueshme ndodh me shitjen ose kur veprimtaria plotëson kriteret për tu klasifikuar si operacion jo i vijueshëm nëse kjo ndodh më shpejt. Kur një veprimtari është klasifikuar si operacion jo i vijueshëm pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve krahasuese riparaqitet sikur operacioni nuk është vijuar që në fillim të periudhës krahasuese. Shoqëria është në proces likuidimi. Me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tirane, nr. 14014/5 datë 26.03.2004, shoqëria ka kaluar në likuidim sipas Urdhërit nr. 38 datë 01.03.2004, të Ministrit të Ekonomisë.

SHPJEGIME PËR ZËRAT KRYESORË TË PASQYRAVE FINANCIARE

4 Aktive Monetare

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Vlera monetare ne banke	1,065,349	225,124
Vlera monetare ne arke	-	-
Totali	<u><u>1,065,349</u></u>	<u><u>225,124</u></u>

5 Llogari/ Kërkesa te arketueshme

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kliente	51,173,676	12,407,940
Zhvleresimi i kërkesave te arketueshme	-	-
Totali	<u><u>51,173,676</u></u>	<u><u>12,407,940</u></u>

ALBKROM SH.A. SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER
 SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE
 (Shumat janë të shprehura në Lek)

6 Llogari/ Kërkesa te tjera te arketueshme

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paradhenie per punonjesit	364,000	-
TVSH e zbriteshme	68,302,860	72,230,655
Debitore te tjere	29,395,918	72,258,184
Zhvleresimi i kerkesave te tjera te arketueshme	-	(5,959,740)
Totali	<u>98,062,778</u>	<u>138,529,099</u>

7 Inventari

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Materiale te tjera	14,236,863	14,236,863
Materiale rikupero	28,633,850	28,633,850
Produkte te gatshme (mineral kromi)	3,933,232	24,134,612
Materiale	4,724,012	26,785,753
Zhvleresim i materialeve te tjera	(13,163,443)	(33,702,480)
Zhvleresim i produkteve te gatshme	(2,681,599)	(14,094,484)
Zhvleresim i inventareve rikupero	(28,633,850)	(28,633,850)
Totali	<u>7,049,065</u>	<u>17,360,264</u>

Materialet e tjera perfaqesojne gjendje stoqe materiale jashtepedorimit, per te cilat eshte llogaritur zhvleresim per shumen 13.163.443 leke.

Magazina e materialeve rikupero perfaqesohet nga vlera e gomave per asgjësim e mbartur nga bilancet e mëparshme. Për këtë inventar është llogaritur zhvlerësimit 100% të vlerës së tij.

Produkti i gatshëm është vlerësuar me vlerën neto të realizueshme, duke marrë për bazë vlerësimin nga ekspertë vlerësues. Për diferencën e krijuar ndërmjet vlerës kontabel (kosto historike) dhe vlerës neto të realizueshme është llogaritur një zhvlerësimit i tij.

Zeri materiale , perfaqeson kryesisht hekur skrap sipas vleresimit nga ekspertë vlerësues dhe disa materiale te tjera.

8 Investimet financiare afatgjata

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Llogari / Kërkesa te arketueshme afatgjata	1,400,101	1,629,137
Totali	<u>1,400,101</u>	<u>1,629,137</u>

ALBKROM SH.A. SHQËRRI NE LIKUIDIM E SIPER
 SHËNIMET SHPIEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE
 (Shumat janë të shprehura në Lek)

9 Aktive afatgjata materiale												
	Toka	Galeri	Ndërtesa Industriale	Ndërtesa Civile	Vepra Infrastrukturore	Ndërtesa Total	Makineri paisje	Mjete transporti	Pajisje Zyre	Pajisje Informata tike	Totali	
Kosto më 31.12.2013	68,335,634	1,311,659,740	123,246,977	58,905,487	91,639,826	273,792,290	41,622,662	169,635,703	2,217,664	628,138	1,867,891,831	
Pakësime (nxjerje jashtë përdorimit)	-	-	-	-	-	-	-	128,804,483	55,000	-	128,859,483	
Shitje	-	-	8,100,000	1,400,000	-	9,500,000	-	2,625,340	-	-	12,125,340	
Blerje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	36,080	36,080	
Kosto më 31.12.2014	68,335,634	1,311,659,740	115,146,977	57,505,487	91,639,826	264,292,290	41,622,662	38,205,880	2,162,664	664,218	1,726,943,088	
Amortizimi												
Akumuluar	-	1,260,622,522	104,759,930	50,069,664	85,205,042	240,034,636	21,255,368	161,754,787	2,213,164	623,728	1,686,504,205	
Pakësime (nxjerje jashtë përdorimit)	-	-	-	-	-	-	-	123,601,410	-	-	123,601,410	
Pakësime (Shitje)	-	-	6,885,000	1,190,000	-	8,075,000	-	2,538,955	55,000	-	10,668,955	
Amortizimi 2014	-	1,260,622,522	97,874,930	48,879,664	85,205,042	231,959,636	21,255,368	35,614,422	2,158,164	623,728	1,552,233,840	
Amortizimi Akumuluar												
31.12.2014	-	1,260,622,522	97,874,930	48,879,664	85,205,042	231,959,636	21,255,368	35,614,422	2,158,164	623,728	1,552,233,840	
Vlera kontabel neto												
31.12.2013	68,335,634	51,037,218	18,487,047	8,835,823	6,434,784	33,757,654	20,367,294	7,880,916	4,500	4,410	181,387,626	
Vlera kontabel neto	68,335,634	51,037,218	17,272,047	8,625,823	6,434,784	32,332,654	20,367,294	2,591,458	4,500	40,490	174,709,248	

ALBKROM SH.A. SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER
 SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE
 (Shumat janë të shprehura në Lek)

10 Aktive afatgjata jomateriale		
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Aktive te tjera afatgjata jomateriale	3,984,058,464	3,984,058,464
Totali	3,984,058,464	3,984,058,464
11 Huate dhe parapagimet		
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Paga e shperblime	5,059,886	-
Parapagime te arketuara	242,420	242,420
Personel i jashtem-Keshilli mbikqyres	379,431	-
Detyrime personel jashtem- pastrim, roje	103,500	-
Detyrime dieta per punonjesit	246,660	-
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	298,113	317,148
Tatim mbi te ardhurat personale	284,362	105,082
Tatimi ne burim	23,114	-
Totali	6,637,486	664,650
12 Huat afatgjata		
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Hua dhe detyrime afatgjata	63,144,352	63,144,352
Totali	63,144,352	63,144,352
13 Huamarrje te tjera afatgjata		
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Furnitore	159,448,010	67,333,994
Kreditore te tjere	223,701,807	229,167,702
Totali	383,149,817	296,501,696
14 Grantet dhe të ardhurat e shtyra		
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Grantet dhe të ardhurat e shtyra	106,201,290	106,201,290
Totali	106,201,290	106,201,290
15 Te drejta e detyrime te Konçensionarit		
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Te drejta e detyrime te Konçensionarit	2,342,415,718	2,342,415,718
Totali	2,342,415,718	2,342,415,718

ALBKROM SH.A. SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER
 SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE
 (Shumat janë të shprehura në Lek)

16 Kapitali

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kapitali aksionar	3,405,413,240	3,405,413,240
Rezerva rivleresimi	1,547,029,358	1,547,029,358
Rezerva ligjore	39,410,111	39,410,111
Rezerva të tjera	25,074,303	25,074,303
Humbje të mbartura	(3,598,514,639)	(3,461,739,282)
Humbje e vitit financiar	(2,442,354)	(28,517,782)
Totali	1,415,970,019	1,526,669,948

Ne pasqyren e ndryshimeve ne kapital, humbjet e mbartura jane shtuar per 108.257.575 leke per te reflektuar sistemimin e veprimeve të detyrimeve debitore dhe kreditore nga vite te kaluara.

17 Shitjet Neto

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shitje mineral kromi	11,054,815	4,908,240
Shitje materiale	7,423,876	-
Totali	18,478,691	4,908,240

18 Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga shitja AAM	15,146,150	20,183,320
Vlera kontabel e AAM	(6,714,458)	(437,400)
Te ardhura nga qirate	2,094,978	1,983,382
Te ardhura nga Buxheti, subvencione	1,000,000	750,000
Rimarrje shumave parashikuara zhvlersime AASH	-	4,035,054
Te tjera te ardhura	734,200	916,321
Totali	12,260,870	27,430,677

19 Ndryshimet ne inventarin e prodhimit ne proces

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Ndryshimet ne inventarin e prodhimit ne proces	11,947,007	3,700,000
Totali	11,947,007	3,700,000

20 Materiale te konsumuara

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Materiale te shitura	1,286,238	-
Totali	1,286,238	-

ALBKROM SH.A. SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER
SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE
(Shumat janë të shprehura në Lek)

21 Kosto e Punes

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Paga e personelit	12,697,326	13,708,085
Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetimore	2,106,425	2,236,492
Totali	14,803,751	15,944,577

22 Amortizimet dhe zhvlersimet

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Amortizimet dhe zhvlersimet	-	7,295,040
Totali	-	7,295,040

23 Shpenzime te tjera

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzime per qira	132,000	132,000
Shpenzime mbyllje galerish	760,320	93,249
Shpenzime per kancelari	117,606	190,798
Sherbime zyra regjist pasurise	90,000	17,000
Sherbime te tjera	1,508,350	2,200,833
Mirembajtje, riparime, pjese ndrimi	185,200	-
Shpenzime sigurimi	14,680	-
Shpenzime karburanti	400,380	184,080
Shpenzime per honorare, etj.	1,117,590	1,055,000
Shpenzime per udhetim e dieta	598,660	597,000
Bl.energji,avull,uje	95,763	85,622
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	51,054	69,512
Komisione bankare	17,349	22,928
Taksa	38,343	-
Penalitete, gjoba e demshperblime	19,957	1,820,156
Shpenzime te tjera	22,869	27,822,540
Totali	5,170,120	34,290,718

24 Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzime per interesa	(5,955)	-
Te ardhura nga interesat	-	373,636
Totali	(5,955)	373,636

25 Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimi

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Humbje nga kembimet valutore	(1,364)	-
Fitim nga kembimet valutore	32,520	-
Totali	31,156	-

ALBKROM SH.A. SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER
 SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE
 (Shumat janë të shprehura në Lek)

26 Shpenzimet e Tatimit mbi Fitimin

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Humbja para tatimit	(2,442,354)	(28,517,782)
<i>Shpenzime te pa zbritshme</i>	19,957	1,820,156
Gjoha demshperblime	19,957	1,820,156
Tatimi mbi fitimin (15%)	-	-
Humbja neto e vitit financiar	(2,442,354)	(28,517,782)

27. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së bilancit të cilat do të kërkonin korrigjime apo shënime sqaruese në pasqyrat financiare.

Likujdatori

Z. Mentor Spahiu

Kryetari Degës së Financës

Zj. Esmë Selmani